



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:051576  
Datë: 15.10.2024  
Numri i dokumentit: 06299433

**K.DH.SH.II.nr.873/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rruga “Armend Daci”, nr.1, kundër debitorit “Lindi Company” SH.P.K., me NUI: 811280073, me seli në Pejë, fshati Kliqinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1949/23, të datës 26.12.2023, me datën 15.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit “Lindi Company” SH.P.K., me seli në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1949/23, të datës 26.12.2023, me datën 06.09.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1949/23, të datës 26.12.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Lindi Company” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.9/23 të datës 23.01.2023, të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljës së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.9/23 të datës 23.01.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor – Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me numër 3051, të datës 10.08.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit shumën prej 15,868.75 €, në emër të gjobës administrative si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me tarifat në fuqi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes ndalimit, sekuestrimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, regjistrimin, sekuestrimin, shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe nga shitja e tyre të realizohet detyrimi ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se urdhri për caktimin e përmbarimit është marr në shkelje të dispozitave të LPP-së, për faktin se vendimi mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura përmbarimore nuk është dokument përmbarimor. Tutje ka theksuar se kundër këtij vendimi debitori ka ushtruar padi, andaj gjykata në vlerësim të kësaj do të duhej ta shfuqizonte urdhrin përmbarimor, dhe të pritej vendimi përfundimtar i gjykatës. Gjykatës i ka propozuar që ta shfuqizoj urdhrin përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të pa argumentuar me asnjë fakt dhe provë siç parashihet me nenin

71 të LPP-së. Ka kundërshtuar pretendimin e debitorit sa i përket vlefshmërisë së urdhrin përmbartimor, pasi që organi përmbartues urdhrin përmbartimor e ka nxjerrë në pajtim me ligjin dhe se aktvendimi në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi është në kopje të vërtetuar dhe i njëjti përmban klauzolën e përmbartueshmërisë. Sa i përket pretendimit lidhur me paraqitjen e padisë, ka deklaruar se padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.873/24 të datës 26.12.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit "Lindi Company" SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.9/23 të datës 23.01.2023, të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në rastin konkret dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktvendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me numër 3051, të datës 10.08.2021, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimi e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me numër 3051, të datës 10.08.2021, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me numër 3051, të datës 10.08.2021, është dokument i përmbartueshëm dhe i cili vendim është bërë i formës së prerë me datë 13.09.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 29.09.2021, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbartim.

Kjo gjykatë i vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por gjeti se janë të pa bazuar për shkak se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore kështu që nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.873/24 me datë 15.10.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri